

Si të organizohet një laborator

Objektivat e një laboratorit pret 5 orësh

- Të paraqitet shtrirja e problemit
- Të shqyrtohen shkaqet e thella
- Të bëhet një reflektim teologjik mbi problemin
- Të dallohet se në çfarë mënyre pjesëmarrësit mund të përfshihen në aktivitetet e parandalimit ose rehabilitimit.

Ja disa sugjerime për organizimin e laboratorit. Nëse keni ide të tjera ose shembuj të tjerë të përshtatshëm, mos ngurroni që t'i përdorni.

Numri i përbërësve të çdo grupi mund të ndryshojë; megjithatë, formimi i grupeve prej 15-20 personave do të jetë zgjidhja më e mirë. Grupet mund të përbëhen vetëm nga gratë, ose mund të jenë të përziera. Për disa ushtrime, kush organizon laboratorin mund të preferojë grupe të përbërë vetëm prej burrave ose vetëm prej grave. Pasi të ballafaqohet në këto grupe të vogla, pjesëmarrësit mund të kthehen në grupe të përziera më të madh në numër. Në grupet e vogla zakonisht personat arrijnë të flasin më lirisht.

Skema e laboratorit

1. Ushtrimi hyrës	30 minuta
2. Ushtrimi mbi përhapjen e fenomenit të trafikimit	60 minuta
3. Përcaktimi i trafikimit	40 minuta
4. Puna në grup	45 minuta
5. Asambleja plenare	45 minuta
6. Reflektimi /lutja	30 minuta
7. Përfundimi/vlerësimi	30 minuta

1. Ushtrimi hyrës (30 minuta)

Si gjë e parë, jepuni mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe përmbledhni objektivat e laboratorit. Grupi mund të ulet në rreth. Ai që organizon laboratorin fillon të prezantohet, duke thënë emrin e tij dhe duke plotësuar fjalinë "Trafikimi për mua është...". Secili nga

pjesëmarrësit e grupit është i ftuar të prezantohet po në të njëjtën mënyrë.

2. Ushtrimi mbi përhapjen e fenomenit të trafikimit: A ose B (60 minuta)

A: Duke u bazuar mbi Seksionin Blu të kit, vendosni cilat nga pohimet e mëposhtme janë të vërteta ose të rreme.

- (a) Për pjesën më të madhe të grave kontakti i parë me trafikuesit ndodh me personat e panjohur.
- (b) Mund të pohohet të qenurit objekt i trafikimit vetëm nëse është marrë me forcë.
- (c) Nëse lejohet të ndiqet një person, nuk mund të deklarohet viktimë e trafikimit.
- (d) Nuk ekziston një përcaktim i përgjithshëm i njohur për trafikimin.
- (e) Të gjitha viktimat e trafikimit mbrohen, jo vetëm ajo që mund të tregojë se ka qenë e detyruar.
- (f) Një pjesë e madhe e trafikimit ndodh për qëllime prostitucioni dhe për format e tjera të shfrytëzimit seksual.
- (g) Elementi kyç i trafikimit është zhvendosja përtej kufijve.

B: Për të bërë këtë ushtrim, përdorni Shtojcën 1 dhe informacionet e tjera me të cilat, mbi të gjitha falë Web-it , mund t'i dispononi. Shënoni në një hartë gjeografike të planetit përshkrimet e trafikimit me ngjyra të ndryshme në këtë mënyrë:

Lapsi i kuq: trafiku që vjen nga Amerika e Jugut

Lapsi jeshil: trafiku që vjen nga Azia

Lapsi blu: trafiku që vjen nga Afrika

Lapsi i zi: trafiku që vjen nga Evropa

Lapsi i verdhë: trafiku që vjen nga Amerika e Veriut
Lapsi kaf: trafiku që vjen nga Australia

Bëjeni këtë ushtrim vetëm, më pas ndahuni në grupe të vogla për të diskutuar mbi atë që keni mësuar nga ushtrimi.

- A ka ndonjë gjë që ju ka habitur?
- Në cilat pika të punës tuaj, të tjerët ishin dakord me ju?
- Në cilat pika të punës tuaj, të tjerët nuk ishin dakord me ju? Si e zgjidhët këtë?
- Cilat pyetje kanë dalë për ju? Cilat për grupin?

3. Përcaktimi i trafikimit (40 minuta)

Duke përdorur Seksionin Blu, secili të zgjedhë një histori nga (a) deri tek (e). Lexoje me vëmendje të paktën dy herë. Më pas pyet veten me këtë pyetje (shih faqen 8):

- Çfarë ndjenjash ka nxitur në ty leximi i historisë?
- Çfarë ke mësuar përsa i përket trafikut? Kë përfshin?
- Shkruaj përcaktimin tënd të trafikut duke filluar me fjalinë: **Trafiku i grave dhe i fëmijëve do të thotë...**

Bashkëndarje në grup e reflektimeve dhe përcaktimet:

- Ke zbuluar ndonjë gjë që të ka habitur?
- A ka pasur marrëveshje mbi atë që keni bashkëndarë?
- A ka pasur ndonjë mosmarrëveshje mbi ndonjë pyetje? Si e keni zgjidhur?
- Çfarë pyetjesh ka nxitur brenda jush? Dhe ne brendësi të grupit?

4. Puna në grup – Shkaqet dhe mekanizmat (45 minuta)

Ndani në dysh grupin: në Seksionin e Verdhë, një pjesë do të shqyrtojë shkaqet dhe tjetri

mekanizmat, duke u përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

Seksioni i Verdhë (Shkaqet)

Cilat janë shkaqet që përcaktojnë praktikimin e trafikimit? Këshillohuni dhe bëni një listë të shkaqeve të mundshme. Më pas dalloni 5 më të rëndësishmet, duke motivuar zgjedhjen tuaj.

Seksioni i Verdhë (Mekanizmat)

A mund të veni në listë kategoritë e ndryshme të personave që janë përfshirë, drejtpërdrejt ose në mënyrë jo indirekte, në trafikimin e grave dhe të fëmijëve? Dalloni 3 që të flisni.

Rezultati i diskutimit mund të prezantohet në mënyrë krijuese në seksionin plenar.

5. Asambleja plenare (45 minuta)

Çdo grup i vogël duhet të paraqesë përfundimet e veta në mënyrë krijuese (me vizatime ose grafikë, me dramatizime, etj.). Më pas mund të ketë kohë për sqarime dhe diskutime.

6. Reflektimi dhe lutja (30 minuta)

Duke përdorur materialin e kit, merrni kohë për

- të dëgjuar thirrjen e vuajtjes së viktimave të trafikimit
- të dëgjuar Fjalën e Jetës që dënon këtë të keqe dhe që shëron atë që ka zemrën e thyer.
- të dëgjuar thirrjen vetjake në përfshirje dhe në veprim.

7. Përfundimi dhe vlerësimi (30 minuta)

Çdo pjesëmarrës, duke përfshirë atë që ka organizuar laboratorin, citon një element që ka hasur veçanërisht të rëndësishëm dhe interesant në kursin e laboratorit.